

dosje.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 12308 Prot

Shkodër, më 16 / 7 / 2021

**Lënda :** Kërkesë për marrjen e vendimit përfundimtar, heqjen e pezullimit dhe lejimin e vijimit të procedurës së ankandit publik me objekt: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia”, sh.a në masën 100%.

**KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Adresa : Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, kati 1, Tiranë .

Të nderuar ,

Në vijim të komunikimit zyrtar ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Komisionit të Prokurimit Publik, Tiranë në lidhje me ankesën e subjektit “bashkimi i operatorëve

nr.973/2021.prot (në kpp),

datë 02.06.2021, që po shqyrtohet nga ana Juaj për procedurën e ankandit publik me këto të dhëna:

1. Autoriteti shitës : Bashkia Shkodër
2. Data e zhvillimit te ankandit : 09.03. 2021 , ora 10.00.
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Procedurë e hapur
4. Objekti i Shitjes: Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a, në masën 100%.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Klubi i futbollit “Vllaznia” sh.a, është shoqëri e organizuar në formën e shoqërisë aksionare, e krijuar në vitin 2011, ku aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Shkodër. Në mënyrë më të zgjeruar objekti i shitjes përshkruhet në Shtojcën 10, Specifikimet teknike.
6. Vlera fillestare: 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: Bashkia Shkodër, Rruga 13 Dhjetori, nr 1.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: data 09.03.2021, ora 10.00.
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit: Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë Autoritetit Shitës.

Vlerësojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj, situatën si vijon :

- Bazuar në ligjin nr.79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar me ligjin 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, neni 7 “Sporti në Republikën e Shqipërisë”, pika 1 citon ...“Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.”; neni 22, Kapitulli shtetëror, përcaktohet ...“1.Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.2.Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive”.
- Referuar ndryshimeve ligjore të sipërcituara, njësitve të vetëqeverisjes vendore i është përcaktuar afati i nxjerrjes në shitje të aksioneve të shoqërive tregtare sportive që kanë zotërim. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.
- Privatizimi i Klubit të Futbollit Vllaznia”,sh.a, është një proces shumë i rëndësishëm për vijueshmërinë e aktivitetit sportiv të këtij klubi “Emblemë e Sportit Shqipëtar me një histori suksesi rreth 100- vjeçare”, njëkohësisht në kushtet ku sipas legjislacionit në fuqi sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.
- Proçedura e ankandit publik me objekt:“Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia”, sh.a në masën 100%, vijon te jetë e pezulluar ne zbatim të vendimit Tuaj nr.973/1 Protokolli, datë 04.06.2021.
- Vlerësojmë se vijimi i pezullimit të proçedurës së ankandit publik me objekt: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia”, sh.a në masën 100%, dëmton interesin publik dhe autoritetin shitës pasi do ketë një tejzgjatje të proçesit të ankandit dhe në këtë mënyrë do rrezikohet veprimtaria sportive e ekipit në kompeticionet europiane duke sjellë një dëm kolosal financiar, si dhe do të dëmtohet serizisht proçesi i privatizimit të klubit.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar, ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, të ndryshuar, VKM 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar, kërkojmë nga ana Juaj :

- **Marrjen e vendimit përfundimtar, heqjen e pezullimit të vendosur nga ana Juaj me vendimin nr.973/1 Protokolli, datë 04.06.2021 dhe lejimin e autoritetit shitës Bashkia Shkodër për vijimin e proçedurës së ankandit publik me objekt: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia”, sh.a në masën 100%.**

Duke Ju falenderuar,

